

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 112, datë 9.7.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 28, DATË 24.2.2023, “MBI BASHKËPUNIMIN E STRUKTURAVE TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME, MINISTRISË SË BRENDSHME DHE MINISTRISË SË FINANCIVE DHE EKONOMISË, PËR GARANCINË FINANCIARE NË PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË VIZAVE PËR TË HUAJT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 18, pika 4, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”; si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim harmonizimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse në procesin e përcaktimit të garancisë financiare, në vlerësimin e vizave për të huajt në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 28, datë 24.2.2023, “Mbi bashkëpunimin e strukturave të ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për garancinë financiare në procedurat e vlerësimit të vizave për të huajt”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në kreun I, pika 1 bëhen ndryshimet si vijon:
 - a) Në shkronjën “a”, togfjalëshi *“Postet konsullore (më poshtë “PDK”)*”, të zëvendësohet me *“Misionet diplomatike dhe postet konsullore (më poshtë “MPDK”)*”;
 - b) Shkronja “c” të riformulohet si vijon:
“c) Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (më poshtë “MEKI”).”
 2. Në kreun II, në fund të pikës 2, të shtohet paragrafi si vijon:
“Përyjashtimisht, shuma e garancisë financiare për studentët e huaj të pranuar nga universitetet publike ose private në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë jo më pak se 300,000 lekë.”
 3. Në kreun III, pika 1, *“Ministria e Financave dhe Ekonomisë”*, të zëvendësohet me *“Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”*.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Taulant Balla

MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT

Blendi Gonxhja

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Igli Hasani